



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 gusht 2017  
Nr. ref.:RK 1119/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI20/17, KI21/17 dhe KI22/17

Parashtrues

**Banka e Kosovës SH.A. Beograd, Jugobanka SH.A., Beobanka SH.A.,  
Beogradska banka SH.A. dhe Momčilo Nedeljković dhe 410 punëtorë të  
tjerë të minierave Kishnica dhe Novobërda**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI20/17 është parashtruar nga Kosovska banka SH.A. Beograd me seli në Beograd (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i parë), e cila përfaqësohet nga Dobrica Lazić, avokat nga Graçanica.

2. Kërkesa KI21/17 është parashtruar nga Jugobanka SH.A., Beobanka SH.A. dhe Beogradska banka SH.A., me seli në Beograd (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i dytë), të cilat përfaqësohen nga Dobrica Lazić, avokat nga Graçanica.
3. Kërkesa KI22/17 është parashtruar nga Momčilo Nedeljković në emër të 410 punëtorëve të tjerë të minierave Kishnica dhe Novobërda (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i tretë), të cilët janë si në vijim:

1. Momčilo Nedeljković,	2. Stana Ivanović,
3. Slobodan Krstić,	4. Zagorka Jovanović
5. Tihomir Nedeljković,	6. Voja Micić,
7. Jovica Milanović,	8. Nuredin (Sadula) Gradina,
9. Zorica Simić,	10. Hazir Haziri,
11. Srbobran Maksimović ,	12. Dušanka Jovanović,
13. Uroš Maksimović,	14. Dragoljub Trajković,
15. Ljifa Ramić,	16. Slobodan (Srećko)Kostić,
17. Šema Jašari,	18. Svetlana Milovanović,
19. Trajko Andrejević,	20. Ljubiša Trajković
21. Radojica Grbić,	22. Slavica (Živojin) Marković 22.11.1956
23. Lutfi Breznica,	24. Trifun Jovanović,
25. Jovica Jorgić,	26. Sretko Janićijević,
27. Mirko (Petar) Aritonović,	28. Predrag (Ranko) Arsić,
29. Ljubiša(Milorad) Simić,	30. Novica Milošević,
31. Milorad (Jordan) Simić	32. Iljmija Zećiri,
33. Zivorad Nedeljković,	34. Stojanka (Radovan) Sekulić, 3
35. Zoran (Stanko) Stošić,	36. Slobodan Janićijević,
37. Zorica Maksimović,	38. Vesna Maksimović,
39. Mirjana Ćirković,	40. Hamdi Garip,
41. Gorica Popović,	42. Milivoj Đorđević,
43. Vesna Krstić,	44. Milica Andrejević,
45. Dobri Filipović,	46. Vlastimir Simić,
47. Jordan Stojanović,	48. Slaviša Krstić,
49. Zoran Lazarević,	50. Pavle Maksimović,
51. Gradimir Mirković,	52. Slaviša (Milivoja) Trajković,
53. Dragoslav Marković,	54. Milorad Mladenović,
55. Miroslav Ivanović,	56. Dragan Aleksić,
57. Ljiljana Filić	58. Slađana Đurović,
59. Zoran Ivić,	60. Branko Pavić,
61. Dobrivoje Dimić	62. Dragiša Todorović
63. Vehbi Bitić	64. Milka Ivanović
65. Bogoljub Micić	66. Živorad Stević
67. Časlav Nedeljković	68. Slavica (Živojin) Marković 11.03.1959
69. Enver Fazlija	70. Radisav Dimitrijević
71. Ljiljana Dimitrijević	72. Stana Kostić
73. Srđan (Novica) Ristić	74. Blagoje Marković
75. Nuredin (Sadula) Gradina,	76. Milica Milanović



77.	Javorka Spasić	78.	Srbobran Janićijević
79.	Branko (Vladimira) Jovanović	80.	Stanimirka Trajković
81.	Blagica Živić	82.	Živka Stević
83.	Veljko Jovanović	84.	Ferdane Nikšić
85.	Zoran (Stanko) Stošić	86.	Slavica Stalević
87.	Jagodinka Vujević	88.	Branislav Andrejević
89.	Živka Čurčić	90.	Milan Danić
91.	Osman Jašari	92.	Branko Đorđević
93.	Dema Jašarević	94.	Radomir Ćirković
95.	Ranko Velić	96.	Dana Milovanović
97.	Velimir Milovanović	98.	Radoslav Miladinović
99.	Branislav Ničić	100.	Slobodan Petrović
101.	Stana Maksimović	102.	Radisav Ivanović
103.	Slavica Vanić	104.	Vojislav Stević
105.	Momčilo Mirković	106.	Vidosav Ilić
107.	Elez Jašarević	108.	Nikola Gudžić
109.	Žika Stević	110.	Milance Čurčić
111.	Dojčin Sekulić	112.	Negovan Marinković
113.	Uroš Stević	114.	Olgica Gudžić
115.	Senad Salijević	116.	Dimitrija Đorđević
117.	Blagica Perić	118.	Zvonimir Marković
119.	Ljubiša Pavić	120.	Živojin Andrejević
121.	Sretko Ničić	122.	Srđan Jovanović
123.	Borisav Andrejević	124.	Branko Todorović
125.	Slobodanka Perić	126.	Miloš Nedeljković
127.	Branka Anderjević	128.	Zoran Stević
129.	Mladen Karadžić	130.	Danica Gudžić
131.	Slađana Dragutinović	132.	Biserka Bulajić
133.	Rodoljub Micić	134.	Jugoslav Nedeljković
135.	Milorad (Miladin) Velić	136.	Draguljub Sevanović
137.	Milan Milić	138.	Zoran Nojić
139.	Milan Jocić	140.	Vlajanka Perić
141.	Branislav Arsić	142.	Milenko Cvejić
143.	Namon Statovci	144.	Verica Vasić
145.	Siniša Maksimović	146.	Veselj Muslijević
147.	Dragan Krstić	148.	Titomir Ivić
149.	Danilo Stevanović	150.	Džema Garip
151.	Dragiša Perić	152.	Emin Gradina
153.	Živojin Živić	154.	Milivoje Simijonović
155.	Medenica Andrejević	156.	Jelica Adamović
157.	Dojčin Đorđević	158.	Dobrila Nedeljković
159.	Milivoje Đekić	160.	Milorad Milovanović
161.	Miloš Radovanović	162.	Dragoljub Stojanović
163.	Šašivar Salijević	164.	Desanka Nikolić
165.	Slobodan Lazarević	166.	Vladimir Petrović
167.	Strahinja Kostić	168.	Nadežda Samardžić
169.	Dejan (Ljubinko) Stojanović	170.	Ljubinko Petrović
171.	Novica Čurčić	172.	Ajredin Gaši
173.	Slađana Ilić	174.	Radomir Ničić

175. Naser Jašarević	176. Slaviša Nedeljković
177. Stanimir Živić	178. Suzana Stevanović
179. Ljubinko Jovanović	180. Refki Salijević
181. Novica Trajković	182. Olga Danić
183. Slobodanka Ničić	184. Dobrivoje Nedeljković
185. Svetomir Cvejić	186. Dejan Živić
187. Gligorije Stoilković	188. Nenad Filić
189. Mile Jović	190. Saša Dragutinović
191. Miro Mirković	192. Živko Marković
193. Srboljub Pavić	194. Srba Marinković
195. Ljubičica Živanović	196. Vesna Džunić
197. Zoran Milovanović	198. Radovan (Božidar) Perić
199. Živorad (Srećko) Jovanović	200. Goroljub Dimić
201. Slavica Golubović	202. Milivoje Janković
203. Vlastimir Petrović	204. Miodrag Kostić
205. Slavica Arsenijević	206. Jovan Ivković
207. Slobodan Arsić	208. Žikica Perić
209. Živojin Zlatković	210. Branka Stojaović
211. Jagoš Stojković	212. Živorad Stošić
213. Mića Martinović	214. Grade Filić
215. Vladimir Mitrović	216. Dejan Simijonović
217. Tihomir Miljković	218. Milorad (Đorđe) Miljković
219. Srećko (Dobri) Savić	220. Srđan Kostić
221. Dobri Savić	222. Ivica Vasić
223. Slađan Simonović	224. Ranko Simonović
225. Svetozar Tasić	226. Živko Maksimović
227. Ljuba Miljković	228. Bojan Pavić
229. Goran Stojanović	230. Ljubisav Savić
231. Slaviša Ristić	232. Živojin Kostić
233. Dragan Marković	234. Mliladin Kostić
235. Srećko (Stanko) Savić	236. Dragi Stojanović
237. Momčilo Ivković	238. Bojan Jovanović
239. Vlada Stošić	240. Branko Dikić
241. Dragan Milovanović	242. Branko (Aleksandar) Jovanović
243. Goran Stošić	244. Slaviša Đokić
245. Branislav Perić	246. Zoran Pavić
247. Stanoja Đorđević	248. Goran Filić
249. Zoran Simijonović	250. Janko Lukić
251. Elez Jašari,	252. Dobrivoje Stević
253. Branislav Dikić	254. Dragan Filić
255. Miodrag Svilanović	256. Stojan Đorđević
257. Mira Antić	258. Goran Ivanović
259. Mira Marković	260. Srđan Vučković
261. Zoran (Slavko) Jovanović	262. Milovan Andrejević
263. Vlastimir Andrejević	264. Trajan ( Uroš) Ivković
265. Miodrag Jovanović	266. Vladimir Živković
267. Dragiša Ivanović	268. Miodrag Simijonović
269. Obrad Perić	270. Zoran Ivković



271. Mirna Živić	272. Slavko Trajković
273. Trajan Filić	274. Goran Pešić
275. Zoran Dikić	276. Svetozar Jovanović
277. Dragan (Novica)Trajković	278. Siniša Stanković
279. Velibor Stajković	280. Predrag (Živko) Arsić
281. Mladen Savić	282. Zaoran Stojković
283. Miodrag Trajković	284. Miro Stojković
285. Trajan (Milutin) Ivković	286. Živorad (Srboljub) Jovanović
287. Nebojša Kostić	288. Miodrag Simonović
289. Nazmi Bunjaku	290. Mileva Danić
291. Mehmet Jašari	292. Alija Osmani
293. Slaviša Kostić	294. Vlastimir (Nikodije) Jovanović
295. Miroslav Andrejević	296. Dragan (Svetko)Trajković
297. Nebojša Stanković	298. Branko Lazić
299. Tihomir Marković	300. Slobodan Marković
301. Goran Ristić	302. Azir Jašari
303. Aleksandar Stanković	304. Negovan Ristić
305. Slobodan (Đorđe) Kostić	306. Slavica Mitić
307. Slobodanka Zdravković	308. Boško Milovanović
309. Goran Stojković	310. Velibor Mirković
311. Vlastimir (Slavko)Jovanović	312. Zlatko Kostić
313. Ismeta Jašari	314. Radovan (Božidar) Perić
315. Boža Ristić	316. Radmila Vasić
317. Milorad (Serafin) Miljković	318. Jana Janković
319. Dragoljub Nedeljković	320. Živko Stojanović
321. Srđan Stanković	322. Branko Ristić
323. Dušica Nedeljković	324. Rada Savić
325. Rasim Shala	326. Anđel Nedeljković
327. Biserka Vasić	328. Nada Josifović
329. Mirko (Petar) Aritonović	330. Milorad (Jordan) Simić
331. Vesna Kostić	332. Stojanka (Radovan) Sekulić 3
333. Slavica Bulajić	334. Srđan Milovanović
335. Milorad Filić	336. Srđan (Novica) Ristić
337. Ivana Ristić	338. Dobrinka Trajković
339. Milan Živković	340. Velimir Ivković
341. Tomislav Perić	342. Randel Milić
343. Ranko Marković	344. Rexhep Bytyqi
345. Obrad Jovanović	346. Dejan (Bogoljub)Stojanović
347. Vlastimir Perić	348. Dragan Živković
349. Zvonimir Đokić	350. Svetozar Lazić
351. Ljubisav Simić	352. Vojislav Stojković
353. Milorad Vasić	354. Hamit Bytyqi
355. Slaviša (Stojan) Trajković	356. Goran Trajković
357. Ljubiša (Milorad) Simić	358. Vebija Tahiri
359. Vladimir Jovanović	360. Mića Kostić
361. Aleksandar Stevanović	362. Saša Jovanović
363. Milorad (Miladin)Velić	364. Branislav Micić
365. Živojin Aleksić	366. Džemalj Salijević
367. Živorad (Sava) Jovanović	368. Zoran Zlatković

369. Stojanka (Radovan) Sekulić 3	370. Dragan Vasić
371. Vojislav Filić	372. Trajan Bogdanović
373. Negovan Mladenović	374. Ljubivoje Nedeljković
375. Živojin Jovanović	376. Ilija Milić
377. Aleksandar Jovanović	378. Miloš Stević
379. Nadežda Trajković	380. Vasiljko Stolić
381. Velija Tairović	382. Milivoje Mitić
383. Miloš Danić	384. Šukrija Šerifović
385. Miodrag Šešlija	386. Živorad Mirković
387. Vladimir Dašić	388. Smiljana Žarković
389. Miodrag Nedeljković	390. Dejan (Novica) Stojanović
391. Slaviša Denić	392. Ljubica Živić
393. Duška Petrović	394. Elena Stanojkovski
395. Ivan Mikić	396. Zorica Velić
397. Radojica Ristić	398. Slavica Kostić
399. Radislav Perić	400. Snežana Živić
401. Zoran Nedeljković	402. Zoran Ničić
403. Goran Miljković	404. Ramadan Jašarević
405. Gordana Popović	406. Nebojša Veselinović
407. Zoran (Dobrivoje) Jovanović	408. Siniša Perenić
409. Zvonimir Stojanović	410. Ivan Đorđević
411. Verica Velić	412.

4. Parashtruesi i tretë përfaqësohet nga Žarko Gajić, Vasilije Arsić dhe Zoran Popović, avokatë nga Graçanica.

#### **Ligji i kontestuar**

5. Të gjithë parashtruesit e kërkesës e kontestojnë përputhshmërinë e Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën (në tekstin e mëtejme: Ligji për Trepçën) me Kushtetutën, të miratuar nga Kuvendi më 8 tetor 2016, të shpallur, të publikuar dhe ka hyrë në fuqi më 31 tetor 2016.

#### **Objekti i çështjes**

6. Objekt i çështjes së kërkesave KI20/17 dhe KI21/17 është vlerësimi i përputhshmërisë kushtetuese të Ligjit të kontestuar për Trepçën, i cili pretendohet të jetë në kundërshtim me të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 46 [E Drejta e Pronës të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: neni 1 i Protokollit nr. 1).
7. Objekt i çështjes së kërkesës KI22/17 është vlerësimi i përputhshmërisë kushtetuese të Ligjit të kontestuar për Trepçën, i cili pretendohet se i ka “mohuar” të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [E Drejta e Pronës], 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës, si dhe me nenin 1 të



Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: neni 1 i Protokollit nr. 1).

8. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme “dhe të ndërpresë zbatimin e (...) Ligjit për Trepçën, nr. 05/ L- 120 (...) derisa të merret vendimi i kësaj Gjykate për përputhshmërinë e këtij ligji me Kushtetutën e Kosovës.”

### **Baza juridike**

9. Kërkesat bazohen në nenet 21.4, 113.7 dhe 116 të Kushtetutës, në nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

10. Më 27 shkurt 2017, parashtruesit i dorëzuan kërkesat KI20/17, KI21/17 dhe KI22/17 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
11. Më 20 mars 2017, në kërkesën KI20/17, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
12. Më 20 mars 2017, në kërkesën KI21/17, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
13. Më 20 mars 2017, në kërkesën KI22/17, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gresa Caka-Nimani
14. Më 31 mars 2017, në kërkesën KI22/17, Gjykata e njoftoi parashtruesin e tretë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata të dorëzojnë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të Momčilo Nedeljković dhe të 410 punëtorëve të tjerë të minierave Kishnica dhe Novobërda.
15. Më 12 prill 2017, në kërkesat KI20/17 dhe KI21/17, Gjykata njoftoi parashtruesin e parë dhe të dytë për regjistrimin e kërkesave të tyre.
16. Më 13 prill 2017, parashtruesi i tretë dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të Momčilo Nedeljković dhe të 410 punëtorëve të tjerë të minierave Kishnica dhe Novobërda.
17. Më 27 prill 2017, Gjykata e njoftoi Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) për kërkesën KI22/17 dhe e ftoi të dorëzojë

komentet të cilat mund t'i ketë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i njoftimit.

18. Më 3 maj 2017, Gjykata njoftoi Kuvendin për kërkesat KI20/17 dhe KI21/17, dhe e ftoi të dorëzojë komente të cilat mund t'i ketë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i njoftimit.
19. Më 4 maj 2017, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI21/17 dhe KI22/17 me kërkesën KI20/17 dhe, rrjedhimisht, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues në të tri rastet mbetën të njëjtë, si në kërkesën KI20/17.
20. Më 5 maj 2017, Gjykata i njoftoi të tre parashtruesit e kërkesës dhe Kuvendin për bashkimin e kërkesave.
21. Më 03 korrik 2017, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

#### **Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesat KI20/17 dhe KI21/17**

22. Më 28 dhjetor 2012, parashtruesi i parë dhe i dytë paraqitën kërkesa në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), si administratore e Kombinatit Xehetaro-Metalurgjik-Kimik Trepça (në tekstin e mëtejme: KXMK Trepça).
23. Më 13 mars 2013 dhe më 20 mars 2013, AKP njoftoi parashtruesin e parë dhe të dytë për regjistrimin e kërkesës kundër KXMK Trepça.
24. Më 31 tetor 2016, Ligji i kontestuar hyri në fuqi.

#### **Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën KI22/17**

25. Parashtruesi i tretë pretendon se ata ishin të punësuar deri në vitin 1999 në Minierën Kishnica dhe Minierën Novobërda, të cilat janë pjesë e KXMK Trepça.
26. Parashtruesi i tretë deklaroi se gjatë muajit qershor të vitit 1999 nga personat e tretë iu ishte pamundësuar paraqitja e rregullt në vendet e punës, dhe për shkak të situatës së sigurisë nuk kanë pasur mundësi të kthehen në vendet e tyre të punës. Ata nuk kishin pranuar asnjë njoftim nga menaxhmenti i KXMK Trepça për mundësinë e kthimit në vendet e punës, dhe as nuk ishin njoftuar për statusin e tyre juridik. Atyre nuk u ishin dorëzuar asnjëherë vendimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në minierat Kishnica dhe Novobërda.
27. Parashtruesi i tretë pretendon më tej se gjatë vitit 2006 ata iniciuan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme procedura kundër AKM-së dhe Administratës së UNMIK-ut, ku kanë kërkuar pagesën e pagave të papaguara, si dhe pagesën e kontributeve përkatëse për fondin pensional. Megjithatë, ata nuk kanë mundur t'i realizojnë kërkesëpaditë e tyre për shkak të moratoriumit



me të cilin është pezulluar zbatimi i të gjitha masave kundër pasurisë ose ndërmarrjeve të cilat janë pjesë e KXMK Trepça.

28. Më 8 tetor 2016, Kuvendi miratoi Ligjin për Trepçën i cili është shpallur, publikuar dhe ka hyrë në fuqi më 31 tetor 2016.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

#### **Pretendimet e parashtruesit të parë dhe të dytë**

29. Pretendimet e parashtruesit të parë dhe të dytë janë krejtësisht identike, dhe si të tilla do të përmenden së bashku.
30. Parashtruesi i parë dhe i dytë pretendojnë se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Trepçën u është shkelur e drejta e pronës.
31. Parashtruesi i parë dhe i dytë kërkojnë nga Gjykata ta shpallë Ligjin për Trepçën në papajtueshmëri me Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe ta shfuqizojë atë Ligj.

#### **Pretendimet e parashtruesit të tretë**

32. Parashtruesi i tretë kërkon vlerësimin kushtetues të përputhshmërisë së neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 14, 15, 16, dhe 17 të Ligjit për Trepçën, duke konsideruar se pretendohet që me këto nene është bërë transformimi pronësor në favor të ndërmarrjes së sapoformuar Trepça SH.A.
33. Parashtruesi i tretë pretendon se me këtë transformim pronësor janë bartur vetëm të drejtat, e jo edhe detyrimet. Këtë qëndrim të tyre e mbështesin me faktin se *“ligji nuk ka dispozita për pasardhësin juridik të detyrimeve”*.
34. Parashtruesi i tretë, më tej, pretendon se ky dështim *“i sjell të gjithë kreditorët e Trepçës, të cilët kanë pasur kërkesa (pretendime) para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në një pozitë më të keqe të mundshme, për shkak se debitori i tyre në një moment është privuar nga të gjitha asetet, pa marrë asgjë në shkëmbim. Dhe, nëse është sipas ligjit, as nuk do të merr asgjë”*.
35. Parashtruesi i tretë i shpjegon këto pretendime duke cituar nenet 14, 15, 16 dhe 17 të Ligjit për Trepçën dhe konsideron se këto *“dispozita shtjellojnë këtë ekspropriim, pasojat, menaxhimin e saj dhe të ngjashme”*.
36. Parashtruesi i tretë thekson se me *“zgjidhjet e miratuara ligjore të cilat nënkuptojnë veçimin e njërive biznesore pa bartjen e detyrimeve dhe bartjen e licencës së vlefshme të Trepçës mbi ndërmarrjen e sapokrijuar, në masë të madhe tregojnë për nevojën e hapjes së menjëhershme të procedurës së likuidimit të Trepçës e cila qartazi mbetet me të gjitha detyrimet dhe ngarkesat e ndërmarrjes të cilat janë krijuar para hyrjes në fuqi të Ligjit për Trepçën. Në këto rrethana, është evidente se në procedurën e likuidimit të Trepçës do të përmbushen vetëm kërkesat të cilat janë të përcaktuara si prioritare është bërë transformimi pronësor në favor të ndërmarrjes së sapoformuar Trepça SH.A.”*

37. Parashtruesi i tretë i kërkesës kërkon nga Trepça *“kthimin në punë, pagesën e të ardhurave të realizuara në shumë prej 200 euro në muaj nga dita e pezullimit të pagesës së tyre, si dhe pagesën e kontributeve përkatëse për fondin pensional në emër të tyre, që të gjitha së bashku paraqesin pronën e parashtruesve të kërkesës”*.
38. Parashtruesi i tretë arsyeton përputhshmërinë me Kushtetutën, duke pretenduar se neni 53 i Kushtetutës parashikon interpretimin e të drejtave të njeriut në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, dhe se me nenin 22 të Kushtetutës është paraparë zbatimi i drejtpërdrejtë i KEDNJ-së. Përveç kësaj, parashtruesi i tretë thirret në një numër të madh të vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilat ata arsyetojnë pranueshmërinë e kërkesës së tyre.
39. Përveç kësaj, parashtruesi i tretë konsideron se me miratimin e Ligjit të tillë për Trepçën, ata nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [E Drejta e Pronës] dhe 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës, si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së, i cili është në zbatim të drejtpërdrejtë në sistemin juridik të Kosovës.
40. Parashtruesi i tretë kërkon nga Gjykata që të konstatojë: *“se atyre iu mohuan të drejtat e garantuara me nenin 46 (E Drejta e Pronës) në lidhje me nenin 156 (Të Drejtat e Grupeve të Veçanta) dhe nenin 31 par. 2 (E Drejta e Trajtimin të Drejtë) të Kushtetutës dhe Ligji për Trepçën 05/ L-120 (Gazeta Zyrtare nr. 36/ 2016) shpallet JOKUSHTETUES dhe shfuqizohet”*.

#### **Kërkesa për masë të përkohshme**

41. Parashtruesi i dytë dhe i tretë kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme, duke përsëritur pretendimet e paraqitura paraprakisht dhe duke pretenduar se nuk është zgjidhur çështja e kreditorëve, ligji pamundëson realizimin e të drejtave të njeriut, ligji nuk përmban minimumin e drejtësisë, ligji nuk është me interes të përgjithshëm, se me këtë ligj i shkaktohet dëm edhe vetë Trepçës.
42. Më tej, ata pretendojnë *“ekzistenca e dëmit të riparueshëm i cili rrezikon sistemin e sundimit të ligjit dhe pasojat e të cilit përhapen në të gjitha subjektet që janë të lidhura me të”*.
43. Në fund, parashtruesit konsiderojnë se *“janë përmbushur kushtet në bazë të nenit 116, paragrafi 2 të Kushtetutës dhe nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese”* prandaj propozojnë që Gjykata të aprovojë masën e përkohshme duke pezulluar *“zbatimin e Ligjit për Trepçën nr. 05/ L- 120 ... derisa të merret vendimi i kësaj Gjykate për përputhshmërinë e këtij ligji me Kushtetutën e Kosovës”*.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

44. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të parapara më tej me Ligj dhe të parashikuara në Rregullore të punës.



45. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm në rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
- (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;  
[...]*
- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
46. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 29 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:
- “1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit”.*
47. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
- a) kërkesa parashtrihet nga një palë e autorizuar, ...”.*
48. Gjykata thekson se neni 113.2 i Kushtetutës përcakton se vetëm Kuvendi, Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar për të ngritur në Gjykatën Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
49. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës si individë përjashtohen nga lista shteruese e palëve të autorizuar, e përcaktuar me Kushtetutë, për të ngritur në Gjykatë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutë, duke përfshirë vetë Ligjin e kontestuar për Trepçën.
50. Gjykata rikujton se individët janë palë të autorizuar të ngrenë vetëm çështjen e shkeljeve nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj (Shih Gjykata Kushtetuese, rastet e bashkuara KIO3/13 dhe KO28/13, parashtrues *Demë Dashi dhe të tjerët, dhe Ali Lajçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 qershorit 2013).
51. Në të vërtetë, neni 113. 7 i Kushtetutës nënkupton ankesa të veçanta dhe të drejtpërdrejta për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese si mjetit të fundit për

shkeljet e pretenduara nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë.

52. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të ngritur çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me vlerësimin kushtetues të Ligjit, që të sigurojnë dëmshpërblim në emër të interesit kolektiv. Prandaj, parashtruesit e kërkesës nuk janë palë të autorizuar që të kërkojnë vlerësimin kushtetues të përputhshmërisë së Ligjit të kontestuar për Trepçën.
53. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se Kushtetuta nuk parasheh “*actio popularis*”, d.m.th. individët nuk mund të ankohen në mënyrë abstrakte për legjislacionin që nuk është zbatuar për ata personalisht përmes matjes së zbatimit. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 7525/76, Vendimi i 22 tetorit 1981. Shih po ashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI117/11, Parashtrues *Ridvan Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 korrikut 2012).
54. Gjykata përkujton se një ankesë duhet të sillet nga apo në emër të personave që pretendojnë se janë viktimat të shkeljes së dispozitave kushtetuese. Këta persona duhet të jenë në gjendje të tregojnë se janë “prekur drejtpërsëdrejti” nga masa ndaj të cilës ankohen (shih rastin e GJEDNJ-së *Ilhan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 22277/93, GJEDNJ, Aktgjykimi, i 27 qershorit 2000).
55. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu rikujton se ajo tanimë ka vendosur që “*Ligji për Trepçën nr. 05/L-120 është kushtetues për nga përmbajtja dhe për nga procedura e ndjekur për miratim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës*” (Shih rasti i Gjykatës Kushtetuese KO118/16, parashtrues *Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën nr. 05/L-120, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 tetorit 2016).
56. Prandaj, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 2 të Kushtetutës, nenin 29.1 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, Gjykata konstaton se kërkesat KI20/17, KI21/17 dhe KI22/17 janë të papranueshme.

### **Kërkesa për masë të përkohshme**

57. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata “*të ndërpresë zbatimin ... e Ligjit për Trepçën nr. 05/ L- 120 ... derisa të merret vendimi i kësaj Gjykate për përputhshmërinë e këtij ligji me Kushtetutën e Kosovës.*”
58. Parashtruesit e bazojnë kërkesën në rrezikun e paraqitjes së “*dëmit të riparueshëm i cili rrezikon sistemin e sundimit të ligjit dhe pasojat e të cilit përhapen në të gjitha subjektet që janë të lidhura me të*”.
59. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, në pajtim me rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës, kërkohet:

“*Rregulli 54*”



[...]  
(4) (a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar [...] rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

[...]

Rregulli 55

[...]

(5) Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.  
[...].”

60. Siç u theksua më lart, kërkesat KI20/17, KI21/17 dhe KI22/17 janë të papranueshme, sepse parashtruesit nuk janë palë të autorizuar për të kërkuar vlerësimin e përputhshmërisë kushtetuese të Ligjit për Trepçën. Prandaj, parashtruesit e kërkesës gjithashtu nuk janë të autorizuar të kërkojnë masë të përkohshme. Për këto arsye, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme.

### PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe (2) dhe 116.2 të Kushtetutës, neneve 27 dhe 29.1 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (a) dhe 54 (4), 55 (5) dhe 56 (b) dhe (c) të Rregullores së punës,

### VENDOS

- I. T'I DEKLAROJË kërkesat KI20/17, KI21/17 dhe KI22/17 të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi